



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 801/5 Prot

Tiranë, më 30.12.2020

V E N D I M

Nr. 219, datë 30.12.2020

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit, me kod #3022 për ngritje në detyrë, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Kërkimit Shkencor, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e disa pretendimeve për parregullsi në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë, shpallur me kod #3022,

VËREJ SE:

Nëpërmjet shkresës me nr. 801 prot., datë 23.10.2020 është protokolluar ankesa e nëpunësit *****, përmes së cilës ngrihen pretendime për mosrespektimin e kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil, mbi përbërjen e Komitetit të Pranimi për Ngritjen në Detyrë (KPND), si dhe mbi vendimin e DAP për kryerjen e vlerësimit me shkrim “online” dhe jo fizikisht, me qëllim favorizimin e kandidatit tjetër të kualifikuar në këtë fazë konkurrimi, në procedurën e konkurrimit me kod #3022, “Shpallje për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Kërkimit Shkencor, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë

(MASR), të cilat vijnë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Nga përmbajtja e kërkesës dhe e dokumentave që i bashkangjiten asaj, dërguar nga konkurenti ***** rezulton se, ai aktualisht, mban pozicionin “*Specialist, në Sektorin e Programeve të Zhvillimit të Kërkimit Shkencor*” pranë MASR, duke gëzuar statusin e nëpunësit civil. Në datën 21.08.2020, përmes portalit *online* të Departamentit të Administratës Publike, ka aplikuar për ngritje në detyrë, në konkurrimin me kod #3022, në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Kërkimit Shkencor, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë*”, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Më tej, pasi është pranuar aplikimi me dokumentacionin përkatës, në datën 24.09.2020, është zhvilluar *online* testi me shkrim dhe intervista, për procedurën e ngritjes në detyrë, në përfundim të të cilës janë kualifikuar për fazën e mëtejshme të konkurrimit, kandidati ***** dhe një kandidat tjetër. Sa i takon Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë për pozicionin në fjalë, ai përbëhej nga E. P (përfaqësues i DAP), V. Gj (Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve- MASR), Sh. A (Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore- MASR), K. T dhe R. R, të cilit kanë qenë prezent gjatë zhvillimit të intervistës online.

Në mbështetje të sa më lart, në lidhje me këtë procedurë konkurrimi, kandidati ***** , ka ngritur pretendimet e mëposhtme:

Së pari, sa i takon përbërjes së Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPNĐ), të përmendur si më lart, ankuesi pretendon se, nuk janë respektuar kërkesat e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar.

Konkretisht, nga ana e ankuesit pretendohet se, një nga anëtarët e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPNĐ), nuk gëzon statusin e kërkuar sipas pikës 7, kreu III, i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, i cili përcakton se, në përbërje Komiteti ka pesë anëtarë, ndër të cilët, një anëtar nga njësia përgjegjëse, i cili kryeson komitetin; një anëtar nga institucioni që ka vendin vakant pjesë e kategorisë së mesme drejtuese, i përcaktuar nga DAP-i; eprorin direkt të pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi; dy ekspertë të fushës përkatëse, në varësi të fushës së vlerësimit. Në mbështetje të këtij përcaktimi, kandidati ***** , pretendon se eprori direkt i pozicionin të shpallur, është Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit, të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në MASR, i cili nuk është bërë

pjesë e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND) dhe në vend të tij si anëtar të këtij komiteti, kanë qenë përfaqësues të tjerë nga institucioni i MASR, të cilët nuk kanë marrëdhënie hierarkike me pozicionin e shpallur “Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit të Kërkimit Shkencor”, çka do të thotë se përbërja e KPND-së është në kundërshtim me ligjin dhe vendimi i këtij Komiteti për shpalljen e fituesit për këtë procedurë konkurrimi, duhet të shpallet i paligjshëm.

Së dyti, konkurenti ka ngritur pretendimin se, vendimi i DAP për kryerjen e vlerësimit me shkrim *online* dhe jo fizikisht, me pretendimin për parandalimin e përhapjes së virusit COVID 19, është i pabazë dhe është kryer në këtë mënyrë me qëllim favorizimin e kandidatit tjetër të kualifikuar, sepse në konkurrime të tjera me numër më të madh kandidatësh të kualifikuar, DAP e ka zhvilluar vlerësimin me shkrim, fizikisht.

Në përfundim të ankesës së tij, kandidati ***** ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për konstatimin e shkeljeve ligjore të ndodhura gjatë kësaj faze të procedurës së konkurrimit si dhe rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë në zbatim të kompetencave të ngarkuara nga ligji.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e mësipërme, nëpërmjet shkresës nr. 801/1 prot., datë 17.11.2020, me objekt: “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e kërkesës së kandidatit *****, mbi procedurën e rekrutimit për ngritje në detyrë, shpallja nr. #3022”, kërkoj nga njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, sqarime si dhe dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e këtij të fundit për këtë rast.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Departamenti i Administratës Publike, me shkresën nr.5219/1 prot., datë 25.11.2020, me objekt: “Kthim përgjigje”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 801/2 prot., datë 02.12.2020, si dhe me shkresën nr. 6021/1 prot., datë 27.11.2020, me objekt: “Kthim përgjigje Suajës nr. 801/1 prot., datë 17.11.2020”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 801/3 prot., datë 04.12.2020, ka paraqitur sqarimet për rastin në fjalë, duke i bashkëlidhur kopje të dokumentacionit të ankimeve mbi procedurën e konkurrimit, të paraqitura nga kandidati ***** dhe përgjigjet e kthyera.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të sjellë dhe sqarimeve të dhëna rezulton se, konkurenti ***** ka paraqitur disa ankesa pranë njësisë përgjegjëse DAP, mbi rezultatet e procedurës së ngritjes në detyrë me kod #3022, për të cilat ka marrë përgjigje në çdo rast nga Departamenti i Administratës Publike dhe përmes shkresës nr. 4519/1 prot., datë 07.10.2020 të këtij të fundit, kandidati ***** është njohur me procesverbalin e mbajtur nga KPND, mbi ankimin e tij për këtë procedurë konkurrimi, si organi kompetent i ngarkuar për vlerësimin e kandidatëve.

Më tej, pas analizës së pretendimeve të parashtruara nga ky konkurrent, për shkeljet e pretenduara se janë kryer gjatë procedurës së konkurrimit në fjalë, ka rezultuar sa më poshtë:

Së pari, në lidhje me pretendimin e ngritur për përbërjen e parregullt të KPND-së, sqarojmë se bazuar në kreun III, pika 7, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, anëtarë të Komitetit të Përhershëm për Ngritjen në Detyrë (KPND) janë: përfaqësuesi i njësisë përgjegjëse, i cili kryeson Komitetin, një anëtar nga institucioni që ka vendin vakant pjesë e kategorisë së mesme drejtuese i përcaktuar nga DAP-i; Eprori direkt i pozicionit, për të cilin zhvillohet konkurrimi; dy ekspertë të fushës përkatëse.

Duke marrë në konsideratë dinamikat e burimeve njerëzore të institucionit (vakancat/gjendje shëndetësore/shërbimet, etj), si dhe parimin e efikasitetit të procedurave administrative të konkurrimit të organizuara nga njësi përgjegjëse, në kreun III, pika 12, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, të ndryshuar, përcaktohet se në rast pamundësie të pjesëmarrjes së ndonjërit prej anëtarëve të KPND-së, njësi përgjegjëse merr masa për zëvendësimin e tyre. Bazuar në këtë mundësi që jep dispozita e mësipërme, për shkak të vakancës së pozicionit të Drejtorit të Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në MASR, njësi përgjegjëse në cilësinë e eprorit direkt në KPND, ka ngarkuar nëpunësin ***** (*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore - MASR*), ndërsa në cilësinë e përfaqësuesit të institucionit ***** (*Drejtor i Drejtorisë së Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve - MASR*).

Në këtë rast, konstatohet se njësi përgjegjëse, ka vepruar në shkelje të nenit 4, “*Përkufizime*”, germa e), të ligjit 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, i cili përcakton se, eprori direkt për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera, është drejtori i drejtorisë e në mungesë të tij duhet të tregojë kujdes që zëvendësimi të bëhet ose me një nëpunës që mbante një funksion homolog, me ngjashmëri në natyrën e funksioneve, ose të bëhet nga eprori i “*Drejtorit të Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë*”.

Për këtë arsye, pretendimi i ankuesit ***** , në lidhje me pjesëmarrjen e nëpunësit Sh. A, me funksion “*Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore*”, në rolin e eprorit direkt, në Komitetin e Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND), formalisht, vlerësohet i drejtë. Por, duke mbajtur parasysh faktin se KPND është organ kolegjal, që funksionon në bazë të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*”, vendimarrjen e tij e bën me shumicë votash, çka do të thotë se kjo shkelje e lejuar nga ana e njësisë përgjegjëse, nuk ka prekur vlefshmërinë e procesit të konkurrimit, pasi anëtarët e tjerë, të rregullt, të këtij

komiteti, kanë votuar pa vërejtje, në favor të konkluzionit përfundimtar. Departamenti i Administratës Publike, duhet ta mbajë parasysh këtë rregull të hierarkisë, në rastet e tjera, të ngjashme, të zevëndësimit të anëtarëve të Komiteteve të Pranimit.

Së dyti, sa i takon zhvillimit *online* të procedurave të konkurrimit, konstatohet që në fund të muajit prill 2020, Departamenti i Administratës Publike, për shkak të gjendjes së pandemisë, bazuar në Urdhrin nr. 262, datë 16.04.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 156, datë 10.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar”, procedurat e konkurrimit të kryera pas kësaj, janë zhvilluar tërësisht *online*.

Në vijim, me reduktimin e masave për parandalimin e pandemisë COVID 19, duke respektuar protokollat e parashikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, njësia përgjegjëse ka rifilluar, gradualisht, zhvillimin fizikisht të procedurave të konkurrimit, duke i kombinuar me ato *online*, veprim ky i bazuar në Urdhrin nr. 38, datë 12.05.2020, të DAP, “Për miratimin e rregullores Tip “Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid -19””, ku përcaktohet se gjatë gjendjes së epidemisë, institucionet e administratës shtetërore do të realizojnë veprimtarinë e tyre nëpërmjet kombinimit të punës në ambientet e institucionit dhe punës në distancë, *online*.

Në lidhje me pretendimin tjetër të kërkuarit se, vendimi i njësisë përgjegjëse për kryerjen e vlerësimit me shkrim *online* dhe jo fizikisht, është marrë me qëllim favorizimin e kandidatit tjetër të kualifikuar, vlerësohet se është i pabazuar, pasi vendimi për zhvillimin e procedurave të konkurrimit *online*, ka qenë i diktuar nga situata e pandemisë Covid-19 dhe është bazuar në Urdhrin nr. 262, datë 16.04.2020, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 156, datë 10.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, të ndryshuar”, si dhe Urdhrit nr. 38, datë 12.05.2020, të DAP, “Për miratimin e rregullores Tip “Për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të administratës shtetërore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid -19”, prandaj ai konsiderohet veprim i rregullt, në përputhje me legjislacionin e shërbimit civil dhe kushtet konkrete të pandemisë.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se në veprimet e Departamentit të Administratës Publike, në zhvillimin e procedurës së konkurrimit me kod #3022, nuk konstatohen elementë kundërligjshmërie, të cilat të kenë ndikuar negativisht, në kryerjen e procesit të konkurrimit dhe në cilësinë e vendimmarrjes së KPND.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në mbështetje të neni 34, pika 1, e Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e hetimit administrativ, filluar në bazë të ankesës nr. 801 prot., datë 23.10.2020, të paraqitur nga nëpunësi *****, me pretendime për parregullsi të kryera në konkurrimin për ngritje në detyrë, me kod #3022 dhe arkivimin e çështjes.
2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha